

## ***RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR***

***Drejtuar: Partia Demokratike e Shqiperise***

***Bulevardin Zhan Dark , nr 11, Tirane***

***Komisionit Qendror te Zgjedhjeve***

***Bulevardi Deshmoret e Kombit,Pallati I Koncerteve***

***Tirane***

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar ,ne zbatim te Vendimit te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve nr.969,date 10.08.2015 , Kontrates se sherbimit nr.7670 date23.09.2015 te lidhur me KQZ ,nga ana ime ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar ,si dhe kontraten shtese per percaktimin e modaliteteve te punes dhe pageses lidhur me date 29.09.2015 me Partine Demokratike te perfaqesuar nga z.Arben Ibroja, kemi audituar pasqyrat financiare te Partise Demokratike ,të cilat përbehen nga bilanci kontabël i dates 31 Dhjetor 2014,pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve,pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur financiare ,si dhe përmbledhjen e metodave kontabël dhe shenimet shpjeguese.

### **Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është pergjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Kjo pergjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshëm të përshtatshëm mbi paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi,zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël,dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të asyeshme për rrethanat.

### **Pergjegjesia e Audituesit**

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tone. Auditimi **jone** u bë në përputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.Keto standarte kërkojnë që Ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit.

Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut , audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem

perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave finciare ne menyre qe te hartoje procedurate auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit.

Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut , audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave finciare ne menyre qe te hartoje procedurate auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Auditimi , gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrat financiare.

Ne,besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tone te auditimit .

## **Opinionit**

**Sipas opinionit tonë ,pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Partise Demokratike të Shqipërisë ,me 31 Dhjetor 2014,të rezultatit të saj financiare dhe të flukseve të parave te saj për vitin e mbyllur financiare me 31.12.2014 në përputhje me Ligjin 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”,i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".**

Shkelzen MARGJEKA

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR  
LIC.NR.178 ,DATE 15.10.2008 .

Tirane ,me 16.10.2015

**Partia Demokratike e Shqiperise**  
**BILANCI I FINANCIARE I USHTRIMIT 2014**

A	AKTIVET	shenime	Ushtimi I mbyllur	Ushtimi I mbyllur	Ndryshimi
			31.12.2014	31.12.2013	
<b>I</b>	<b><u>AKTIVET AFATSHKURTER</u></b>				-
<b>1</b>	<b>Mjetet Monetare</b>	<b>skk3</b>			-
(i)	Banka		87,369,494	76,727,778	10,641,716
(ii)	Arka		1,502,247	171,882	1,330,365
	<b>TOTALI I MJETEVE MONETARE</b>		<b>88,871,741</b>	<b>76,899,660</b>	<b>11,972,081</b>
<b>3</b>	<b>Aktivet e tjera financiare afatshkurter</b>	<b>3</b>			-
(i)	Kerkesa te arketueshme				-
(ii)	Debitore te tjere		0	904,981	(904,981)
	<b>TOTALI I AKTIVEVE TE TJERA</b>		<b>0</b>	<b>904,981</b>	<b>(904,981)</b>
<b>4</b>	<b><u>AKTIVET AFATSHKURTER INVENTARET</u></b>	<b>4</b>			-
(i)	Materiale		120,000	98,140	21,860
(ii)	Inventari ime				-
(v)	<b>TOTALI I INVENTAREVE</b>		<b>120,000</b>	<b>98,140</b>	<b>21,860</b>
	<b>TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTER(1+2+3+4+5+6+7)</b>		<b>88,991,741</b>	<b>77,902,781</b>	<b>11,088,960</b>
<b>2</b>	<b><u>AKTIVET MATERIALE AFATGJATE</u></b>	<b>5</b>			-
(i)	Toka				-
(ii)	Ndertesa		27,790,094	29,252,731	(1,462,637)
(iii)	Makineri,inja teknologjike		35,842	44,802	(8,960)
(iv)	Mjete Motorrike		12,548,214	15,685,267	(3,137,053)
(V)	Mobilime dhe orendi zyre		15,690,590	11,070,743	4,619,847
(Vi)	Pajisje zyre				-
	<b>TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATE(1+2+3+4)</b>		<b>56,064,740</b>	<b>56,053,543</b>	<b>11,197</b>
<b>I+II</b>	<b>TOTALI I AKTIVEVE (I +II)</b>		<b>145,056,481</b>	<b>133,956,324</b>	<b>11,100,157</b>

<b>B</b>	<b>DETYRIMET</b>				
<b>I</b>	<b>DETYRIMET AFATSHKURTER</b>	<b>3</b>			<b>-</b>
(I)	Hua afat shkurter				-
(III)	Te pagueshme ndaj furnitorit	4,752,455	6,503,084	(1,750,629)	
(IV)	Te pagueshme ndaj personelit				-
(V)	Te pagueshme ndaj sigurimeve shoqerore	296,678	326,580	(29,902)	
(VII)	Detyrime Tatimore TATIM ne BURIM				-
(VIII)	Detyrime Tatimore TATIM MBI TE ARDHURAT	79,906	117,948	(38,042)	
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE (I+II)</b>	<b>5,129,039</b>	<b>6,947,612</b>	<b>(1,818,573)</b>	
	Parapagimet e arketuara,				-
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE (I+II)</b>				<b>-</b>
<b>C</b>	<b>KAPITALI</b>	<b>3</b>			<b>-</b>
(I)	Pasuria bruto e Partise PD	94,234,884	116,341,906	(22,107,022)	
(II)	Kalimi I teprices se burimeve te ushtrimit paraardhes	32,773,828	-22,107,022	54,880,850	
(III)	Teprica e Burimeve per periudhen kontabel te ushtrimit	12,918,730	32,773,828	(19,855,098)	
(IV)	<b>TOTALI I PASURISE NETO</b>	<b>139,927,442</b>	<b>127,008,712</b>	<b>12,918,730</b>	
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALEVE(I+II+III)</b>	<b>145,056,481</b>	<b>133,956,324</b>	<b>11,100,157</b>	

A	TE ARDHURAT	Ushtimi i mbyllur 31.12.2014	Ushtimi i mbyllur 1.12.2013
1	<b>Te ardhura (burimet)nga veprimtaria kryesore</b>		
(i)	<i>Financime nga buxheti 2013</i>	57,800,343	89,785,001
(ii)	<i>kuota antaresie</i>		
(iii)	<i>Sponsorizime ne ALL</i>		
(iv)	<i>Sponsorizime Te tjera</i>		
(v)	<i>Kuotat e deputetëve</i>	415,000	4,275,000
(Vi)	<i>Kuota antaresie</i>		
(Vi)	<i>Te ardhura nga kompesimi I sigurimee</i>	-	24,680
<b>A</b>	<b>TOTALI I TE ARDHURAVE</b>	<b>58,215,343</b>	<b>94,084,681</b>
<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>		
2	<b>Materiale dhe mallra te konsumuara</b>		(71,191)
(i)	<i>Materiale</i>		
3	<b>Shpenzime te tjera( 61+62+63+65)</b>	<b>(21,896,786)</b>	<b>(38,048,592)</b>
4	<b>Shpenzimet te Personelit (64)</b>	<b>(15,696,324)</b>	<b>(13,004,788)</b>
(i)	<i>Pagat</i>	(13,698,016)	(11,273,477)
(ii)	<i>Sigurime shoqerore</i>	(1,998,308)	(1,731,310)
5	<b>Renia ne Vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi (68)</b>	<b>(7,608,503)</b>	<b>(10,271,092)</b>
(ii)	<i>Amortizimi</i>	(7,608,503)	(10,271,092)
<b>B</b>	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE 1+2+3+4+5)</b>	<b>(45,201,613)</b>	<b>(61,395,663)</b>
7	<b>FITIMI apo HUMBJE nga veprimtaria kryesore(3-6)</b>	<b>13,013,730</b>	<b>32,689,018</b>
	<b>TE ARDHURTAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE</b>		
8	<i>Te ardhurat dhe shpenz financie nga pjesem762-662</i>		
9	<i>Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investimet</i>		
10	<i>Interesa te paguara dhe diferenca kursi negative</i>	(95,000)	84,810
11	<i>Fitimet /Humbje nga kursi I kembimit 769-669</i>		
12	<i>Te ardh/shpenz nga shitja e AAM-vlera/kontabe</i>		
	<b>Totali I te ardhuarve dhe shpenzimeve financ</b>	<b>(95,000)</b>	<b>84,810</b>
<b>C</b>	<b>REZULTATI</b>		
13	<b>FITIM HUMBJE PARA TATIMIT ( 7+/- 15)/kontabel</b>	<b>12,918,730</b>	<b>32,773,828</b>
14	<i>Shpenzimet e panjohura</i>		
15	<b>FITIMI HUMBJE NETO E VITIT FINANCIARE/</b>	<b>12,918,730</b>	<b>32,773,828</b>

**BILANCI I FINANCIARE I USHTRIMIT 2014****PASQYRA E FLUKSIT TE PARAVE**

Pasqyra nr (3)

<b>METODA INDIREKTE</b>	<b>Ushtrimi i mbyllur</b>	<b>Ushtrimi i mbyllur</b>
	<b>31.12.2014</b>	<b>31.12.2013</b>
<b>Fluksi I Parase nga veprimtaria e shfrytezimit</b>	<b>12,918,730</b>	<b>32,773,828</b>
<b>Teprica e burimeve para tatimit</b>	<b>12,918,730</b>	<b>32,773,828</b>
<b>Regullime per:</b>		
<i>Efektet e transaksioneve jomonetare</i>		
<i>Amortzimimi</i>	7,608,503	10,271,092
<i>Provizionet</i>		
<i>Ndryshimet ne tepricen e aktiveve qe rrjedhin nga veprimtarite e shfrytezimit</i>		
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga veprimtarite investuese ose financiare,</i>		
<i>Rritje/renia ne tepricen e kerkesave te arketueshme</i>		61,486
<i>Rritje/renia ne tepricen e inventareve</i>		-
<i>Rritje/renia ne tepricen e detyrimeve per tu paguar</i>	-727,699	(12,568,718)
<i>Parapagimet e arketuara,</i>		
<b>Fluksi I Parase nga veprimtarite financiare</b>		<b>(2,236,140)</b>
<i>Blerjet e aktiveve afatgjata materiale jo materiale</i>	7,619,700	125,819,231
<i>Blerje e njesive te kontrolluara dhe pjesemarrjeve</i>		
<i>Huart e dhena paleve te tjera (pervec institucioneve financiare</i>		
<i>Shitjet e aktiveve afatgjata materiale jo materiale</i>		
<b>Paraja neto nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>7,619,700</b>	<b>125,819,231</b>
<b>Fluksi I Parase nga veprimtaria investuese</b>		
<i>Arketimin e huarave te dhena</i>		
<i>Kthimi I harave te marra</i>		
<i>Pagesat e detyrimeve te qirase financiare</i>		
<i>Ndryshimet e pasurise neto</i>		(139,252,016)
<i>Pagesat e Dividenteve</i>		
<b>Fluksi I Parase nga veprimtarite financiare</b>		<b>(139,252,016)</b>
<b>TOTALI I PARASE NETO</b>		
<b>Rritja/renia e mjeteve monetare</b>	<b>10,469,834</b>	<b>17,104,903</b>
<b>Mjete monetare ne fillim te periudhes kontabel</b>	<b>76,899,660</b>	<b>59,794,757</b>
<b>Mjete monetare ne fund te periudhes kontabel</b>	<b>87,369,494</b>	<b>76,899,660</b>

**BILANCI I FINANCIARE I USHTRIMIT 2014**  
**Pasqyra e ndryshimeve ne Pasurine Neto.**  
**mbyllur me date 31.12.2014**

	PASURIA NETO	Teprica	(Pasqyra ne 4) Totali
Shen.	1	2	3
a	e burimev te vitet		
<b>A</b> <i>Pozicioni me 31/12/2012</i>	<b>255,428,652</b>	<b>-21,941,752</b>	<b>233,486,900</b>
<b>1</b> <i>Teprica e Burimeve per periudhen kontabel te ushtrimit2012</i>			
<b>2</b> <i>Burime te tjera</i>			
<b>3</b> <i>Kalimi I teprices se burimeve te vitit 2012ne pasuri neto</i>			
<b>B</b> <i>Pozicioni me 31/12/2013</i>	<b>116,341,906</b>	<b>10,666,806</b>	<b>127,008,712</b>
<b>1</b> <i>Teprica e Burimeve per periudhen kontabel te ushtrimit2013</i>			
<b>2</b> <i>Burime te tjera</i>			
<b>3</b> <i>Kalimi I teprices se burimeve te vitit 2012ne pasuri neto</i>			<b>0</b>
<b>B</b> <i>Pozicioni me 31/12/2014</i>	<b>127,008,712</b>	<b>12,918,730</b>	<b>139,927,442</b>

**Bilanci financiar i ushtrimit te vitit 2014 duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, te cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.**

## TË PËRGJITHSHME

- Partia Demokratike e Shqipërisë u krijua me date 12 dhjetor 1990
- Zyra qendrore ndodhen ne Bulevardin Zhan Dark , nr 11.
- Veprimtaria e Partisë Demokratike, rregullohet sipas Ligjit nr.8580 date 17.02.2000"Per Partite Politike “ndryshuar me ligjin nr10374 date10.02.2011,nga Statuti i tij dhe legjislacionet përkatëse ne fuqi.
- Partia Demokratike e Shqipërisë është parti politike që bashkon në gjirin e saj shtetasit shqiptarë që besojnë, respektojnë e mbrojnë lirinë, dinjitetin e personit, vlerat themelore të familjes në shoqëri, drejtësinë dhe shtetin ligjor, humanizmin e solidaritetin shoqëror. Ajo synon të promovojë në interes të Shqipërisë dhe shqiptarëve, të drejtat qytetare dhe politike të tyre, zhvillimin e nismës së lirë e barazinë në shanse, tregun e lirë e konkurrencën si mjet të zhvillimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit, sigurinë e individit e të pronës, drejtësinë shoqërore e dialogun social, ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit, autoritetin e shtetit dhe vetëqeverisjen e lirë të komuniteteve lokale.
- Partia Demokratikë e Shqipërisë aderon në gjirin e Partisë Popullore Europiane dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga të njëjtat vlera e ideologji.
- PD njeh dhe promovon pjesëmarrjen e gjerë popullore në jetën politike, shoqërore dhe në institucione, si dhe kujdeset për formimin e një vullneti të gjerë e të qëndrueshëm popullor në dobi të mbrojtjes dhe zhvillimit të traditave më të larta shoqërore, politike dhe kulturore të shqiptarëve, në dobi të realizimit dhe zhvillimit të shpejtë të aspiratave euroatlantike të Shqipërisë, si dhe rrezatimin pozitiv të imazhit të vendit kudo në botë, për përjetësimin e kombit shqiptar, identitetin e kulturës së tij.
- PD i realizon objektivat e veta politike nëpërmjet komunikimit politik përmes zgjedhjeve, në përputhje dhe respektim të plotë të kuadrit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Shqipërisë.
- PDSH synon:
  - të ndërtojë një demokraci të të drejtave njerëzore të njohura e të marra në mbrojtje nga dokumentat ndërkombëtare, të mbështetur në bashkësinë e njerëzve të lirë, të përgjegjshëm, që bashkëpunojnë, respektojnë e ndërmarrin përgjegjësi të përbashkëta;
  - të ndërtojë shtetin ligjor me raporte të balancuara e të ndara qartë të pushteteve, garant të jetës, lirive dhe të drejtave të sanksionuara me ligj të qytetarëve;



- të nxisë dhe zhvillojë ekonominë e tregut nëpërmjet nxitjes së iniciativës së lirë ekonomike e shtimit të pronës private si forma mbisunduese në krijimin dhe pronësimin e pasurisë kombëtare, nëpërmjet privatizimit të ndërmarrjeve ekonomike publike, liberalizimit të tregut e licencimeve, zbatimit të politikave favorizuese fiskale e të kreditimit, etj.;
- të garantojë të drejtën e pronës private, paprekshmërinë e saj dhe të drejtën e pronarëve për ta disponuar atë lirisht, trashëguar apo dëmshpërblyer me vlerë të plotë tregu;
- të zhdukë privilegjet dhe pabarazitë që nuk përlligjen as nga puna e prona, as nga talenti e as nga shërbimet e kryera ndaj vendit;
- të promovojë paritetin gjinor në jetën e partisë dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave në organet e zgjedhura dhe ato ekzekutive;
- të integrojë Shqipërinë si anëtare dinjitoze në Bashkimin Europian;
- të garantojë sigurinë kombëtare dhe të kontribuojë si vend anëtar i NATO-s dhe në bashkëpunim me institucionet Europiane, Shtetet e Bashkuara dhe të tjera organizma ndërkombëtar për të siguruar paqen, lirinë, demokracinë, garancinë ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit për të gjithë rajonet dhe më gjerë.
- të mbrojë interesat kombëtare dhe të drejtat njerëzore të shqiptarëve kudo që janë duke respektuar aktet e marrëveshjet ndërkombëtare dhe duke kërkuar standardet e pranuar botërisht për të gjithë; etj.
- Politika e PDSH-së përcaktohet dhe pasqyrohet në programin e saj, si dhe dokumente të tjera që miratohen në përputhje me Statutin nga organet e saj qendrore.

## **BAZAT E PËRGATITJES**

### **Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

## POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### Politikat Kontabël

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Pasqyrat janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike dhe parimit të arkëtimit dhe pagesave, Ato paraqiten në monedhën vendase, Leke Shqiptar "LEK". Përbërësit e pasqyrave financiare

- a) Bilancin kontabël;
- b) Pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve;
- c) Pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta;
- ç) Pasqyrën e rrjedhjes së parasë (cash flow);
- d) Aneksat e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues.

### Transaksionet në monedhë të huaj

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2014 është detajuar si më poshtë:

Kurset e këmbimit  
Euro/Lekë 140.14

### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse në banka.

BNT	Euro	10	Kursi 140.14	1,401
BNT	Lek	64,619,892		64,619,892
RFB	Lek	22,748,201		22,748,201

Vlera totale në të gjitha bankat në datë 31 dhjetor është 87.369.494 lek

Vlera ne arke ne datën 31 dhjetor është 1.502.247 lek

### **Pronësia dhe Pajisje**

PD, zotëron pronësi qe është e përberë nga ndërtesa, mjete transporti dhe inventar ekonomik.

Zërat e detajuara janë si mëposhtë:

<b>Pasqyra e AQT-ve</b>				
		<i>Vlera 01.01. 2014</i>	<i>Amortizimi</i>	<i>Vlera e mbetur 31.12.2014</i>
<i>Ndertesat</i>		<i>29,252,731</i>	<i>1,462,637</i>	<i>27,790,094</i>
<i>Mjete Motorrike</i>		<i>15,685,267</i>	<i>3,137,053</i>	<i>12,548,214</i>
<i>Mobilime dhe orendi zyre</i>		<i>11,070,743</i>	<i>2,767,686</i>	<i>8,303,057</i>
<i>Makineri dhe linja teknologjike</i>		<i>44,802</i>	<i>8,960.40</i>	<i>35,842</i>
<i>Mobilie</i>	<i>Shtator 2014</i>	<i>1,680,000</i>	<i>105,000</i>	<i>1,575,000</i>
<i>Pajisje kompiuterike</i>	<i>Nentor 2014</i>	<i>3,052,000</i>	<i>127,166.67</i>	<i>2,924,833</i>
<i>Pajisje kompiuterike</i>	<i>Dhjetor 2014</i>	<i>2,887,700</i>	<i>0</i>	<i>2,887,700</i>
		<i>63,673,243</i>	<i>7,608,503</i>	<i>56,064,740</i>

Vlera e inventarit te imët është 120.000 leke

Detyrime ndaj furnitorëve janë zvogëluar dhe kane vlerën 1.750.629 leke

Detyrime për tu paguar janë detyrimet ndaj DPT për tatimin mbi te ardhurat nga punësimi dhe kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore ne vlerat si me poshtë

Sigurime shoqërore dhe shëndetësore 276.678 leke

Te ardhurat nga punësimi 79.906 leke

## Kapitali

Pasuria Neto ne fund te ushtrimit është **139,927,442 leke**

Viti 2014 u mbyll me një tepricë të burimeve në vlerën 12.918.730

## Burimet e Financimit

	Financime	Vlera
(i)	Financime nga buxheti 2014	57.800.343
(ii)	Kontributi i deputeteve	415.000
	Totali i të Ardhurave	58.215.343

## Shpenzimet e ushtrimit

	Shpenzimet	Vlera
(i)	Shpenzime për personelin	15.696.324
(ii)	Amortizimi	7.608.503
(iii)	Shpenzime financiare	95.000
(iv)	Shpenzime të tjera	21.896.786
	Totali Shpenzimeve	45.296.613

Pasqyrat financiare u aprovuan dhe u miratuan nga

Etion Kapedani Drejtor Finance \_\_\_\_\_

Arben Ibroja i ngarkuari i Kryesisë \_\_\_\_\_